## Kontejner për mbeturina për çdo familje të Komunës së Hanit të Elezit - *14 tetor 2012*



Hani i Elezit 14.10.2012




Nevoja për investime në kushte e rrethana të kufizuara ,nevoja për ndërgjegjësimin dhe komunikimi me  qytetarët për ta shqyrtuar problemin me  menaxhimin e mbeturinave,bënë që komuna e Hanit të Elezit të hartojë një planë për menaxhimin e mbeturinave i  cili ishte e përkrahur  ng  Projekti Zvicër – Kosovë për përkrahje të qeverisjes lokale dhe Decentralizim LOGOS të implementuar nga Helvetas Swis INTERCOOPERATION.

Pas prezantimin të këtij plani në shtatorë të këtij viti para qytetarëve të komunës së Hanit të Elezit  ku në detale ishin vlerësuar  aspektet financiare dhe operacionale të kompanisë  për realizimin me sukses të këtij plani dhe pas përkrahjes së fuqishme nga vet qytetarët filloi implementimi i tij.

Drejtoria e Shërbimeve Publike  këtë javë në përputhje  me këtë planë filloi implementimin e projektit të shpërndarjes së kontejnerëve për çdo familje të komunës së Hanit të Elezit .

Sipas  këtij projekti do të mbulohen  95% të territorit të komunës,do të ketë orar të saktë të bartjes së mbeturinave ndërsa falë mbështetjes së  Projektit Zvicër – Kosovë për përkrahje të qeverisjes lokale dhe Decentralizim LOGOS të implementuar nga Helvetas Swis

INTERCOOPERATION prej afro 40.000 €, të gjitha familjet e komunës do të furnizohen me kontejner për mbeturina.

Sipas këtij plani secila bashkësi familjare me marrjen e kontejnerit do të nënshkruaj edhe një kontratë me të cilën do të obligohet që të paguan nga 3 € në muaj ,ndërsa bizneset do të paguajnë nga 9 € në muaj. E tërë kjo përllogaritje është bërë me çmimin minimal të kostos së përgjithshme .